



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 2, pika 2.2, nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30, për ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, dhe të nenit 16, nenit 51, pika 51.1, shkronja I të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.04.2008, merr

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL
PËR SIGURINË E BASHKËSIVE

- I. Formohet Këshilli komunal për sigurinë e bashkësive.
- II. Këshilli përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë: shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës së Prishtinës (LDK, AKR, PDK, ORA, AAK, LDD, PD, KDTP), dy përfaqësues nga komuniteti serb, një përfaqësues nga komuniteti boshnjak, një përfaqësues nga komuniteti rom, një përfaqësues nga komuniteti ashkali dhe dy përfaqësues nga bashkësitë lokale.
- III. Detyrë e këtij Këshilli është që ta identifikojë dhe ta adresojë me efikasitet çështjen e krimit dhe të sigurisë brenda komuniteteve të tyre.
- IV. Këshillin e kryeson kryetari i Komunës së Prishtinës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.110-431, më 11.04.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa